



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 07.08.2026

**MBLEDHJA Nr. 35,
Datë 10.08.2026, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 10.08.2026, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 35 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s nr. 30, dt. 06.07.2026; nr. 31, dt. 13.07.2026; nr. 32, dt. 21.07.2026; nr. 33, dt. 24.07.2026; nr. 34, dt. 28.07.2026.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin korrik 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “GLOBAL INTERPRISE GROUP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “3X ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “KRONOS KONSTRUKSION” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.
11. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemit”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.
12. Mbi kërkesën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e saj.
13. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra LIKA